

glave mrtvaca zadesila), (14); *Nanë vjet, djalë, ethet të kin zanë (Ne bi te za devet godina pustila groznica, momče)*, (17) e shumë të tjera.

f) M. fjalën *kushtrim* e sqaroi në skr. me: „Ko je junak”, „kojunak” e „kovitez”, por në tekstet e mëtejme nuk e përktheu fare dhe bëri mirë, sepse kështu i doli më e fuqishme, më e lëngshme. Kështu, mendojmë se do të duhej të vepronte edhe me emrin (*shka* (shkja) e *shkie* (shkje), të cilit është vështirë t'i gjendet ndonjë fjalë gjege në gjuhën e përkthimit. Andaj, nuk na duket qëlluar që në të gjitha rastet e përktheu me *slaven* dhe *slaveni*, sepse pavarësisht pse një shpjegim të tillë mund t'i ketë dhënë ndonjë linguist këtij emri, e vërteta është se rapsodi shqiptar nuk e përdor me atë kuptim. Këto fjalë këtu kanë kuptim etnografik; ato tregojnë banorin e Krajlisë, njerëzit e krajlave që luftojnë kundër tyre, gjithë ata që jetojnë rreth e qark atdheut të kreshnikëve. Përndryshe, në këtë kontekst ne mund t'i sjellim Miqoviqit me dhjeta e dhjeta shembuj, kur kreshnikët

shqiptarë shkojnë në Talir (Ita More (Greqi), Maxharr, Miskov, Qesar (Austri), Nemc (Gjermani) e ndonjëherë edhe në Bagdat, që ishte radiusi më i gjerë i bredhjeve të tyre në aventurat martesore e të tjera dhe, prore rapsodët do të thonë, në mënyrë të përgjithësuar, se kanë shkuar ndër shkje. Për më tepër nocioni *slaveni* nuk përkon, kur dihet se këta heronj nuk luftuan kundër kurrfarë kombi e feje, por në shënjestër patën prore krajlrat e ndryshëm, kapidanët dhe sejmënët e tyre.

Këto qenë vetëm disa nga vërejtjet tona përkthimi me përkthimet e dobëta të këngëve kreshnike shqiptare, duke mos pretenduar se i kemi thënë të gjithat, sepse ka aq shumë e për të cilat do të mund të shkruhej një vepër e tërë. Megjithatë, do pranuar se një përkthim të mirë të kësaj lënde kaq të pasur me fjalë e shprehje, me figuracion poetik kaq të dendur e të qëlluar, do të mund ta bënte vetëm një njohës i mirë i të dy gjuhëve, i cili do të kishte edhe një dell të mirë e vesh të hollë poeti.

DEMUSH SHALA

Dushko Naneski: KALI I ZANËS (Përralla popullore maqedone) botoi „Rilindja”, Prishtinë, 1981.

Dushko Naneski është një nga kritikët e njohur maqedonas. Është i orientuar më shumë kah poezia, me interesim të posaçëm për artin poetik popullor: shpjegon mitet e simbollet, ndjek gjuhën e tyre deri te shprehja moderne. Ka botuar deri tash këta libra: „*Këngë popullore të dashurisë*”, 1971, „*Shkolla poetike maqedone*”, studime dhe ese, 1977, „*Bilbili i zi*” antologji e poezisë maqedone, ndërsa veprën „*Kali i Zanës*” (Përralla popullore maqedone) me stil të autorizuar e botoi më 1978.

Libri i tij „*Kali i zanës*” (Përralla popullore maqedone) doli si botim i „Rilindjes” edhe në gjuhën shqipe në vitin 1981.

Libri përmban një parathënie të shkurtër nga vetë autori, ku, ndër të tjera, thekson metodën e punës dhe qëllimin e ndërmarrjes së tij për t'u dhënë lexuesve një libër me përralla të zgjedhura sipas shijes së tij e sidomos edhe të përshtatura në gjuhën

letrare në stilin e tij poetik, ashtu siç patën vepruar para tij për lexuesit e tyre Vëllezërit Grim dikur, Charl Pero ose Rozhan Nemocova, duke bërë transliterimin e gjuhës së folklorit në atë letrare. Libri përmban edhe një parathënie dhe një pas-thënie nga përkthyesi.

Duke lexuar përrallat e këtij libri, vërtet bindemi për bukurinë që përmbajnë përrallat si art gojor i popullit. Këtu janë përfshirë njëzet sosh. Këto përralla të përkthyer shqip vijnë e hyjnë në botën tonë shpirtërore duke na kënaqur me përmbajtjen që sublimojnë, me mjetet e bukura artistike, e sidomos me simbolikën e qëlluar. Ja pra një vepër që do të lexohet me ëndje si nga të vegjlit ashtu edhe nga të rriturit: prindërit, mësuesit dhe studiistët e folklorit.

Dihej fare mirë se përrallat janë të ngjashme ndër të gjithë popujt e botës. Dhe kryesore e me rëndësi është një çështje: ato janë gjithkund,

te secili popull të bukura, tërheqëse, edukative, interesante, siç e pohon edhe ky libër. Njohësit e folklorit kanë bërë krahasime ndër popujt e ndryshëm të botës dhe kanë vërejtur pikat afruese e dalluese të përrallave. Vallë, kush do t'i ketë krijuar i pari këta margaritarë? — Është kjo një pyetje që ka vetëm një përgjigje: i ka krijuar njeriu, ai që vuante dhe ëndërronte jetën më të mirë, ai që synonte me shekuj të përmirësonte atë, që i kishte në zemër të mirat morale e rreth tij të mirat materiale. Duke lexuar këtë libër me përralla mësojmë se njeriu kudo është njeri dhe ka hallet e telashet e përbashkëta jetësore, ka dëshira e plane të ngjashme, vështirësi e peripetia të ngjashme dhe të duket si njeriu i mesit ku jeton dhe punon.

Përrallat janë vërtet krijimet më të bukura e më të kuptueshme të njerëzimit. Edhe në ditët tona, jo vetëm që dëgjohen me kënaqësi, mblihen e studiohen, por edhe shfrytëzohen si lëndë në artet e tjera massive, si në atë kinematografik e televiziv. Filma artistikë vite me radhë mbushin sallat e kinemave, pikërisht duke pasur për bazë përrallat. Sa filma të bukur janë shfaqur nga vepra monumentale e përrallave të Lindjes „Një mijë e një net”, sa filma të tjerë ndiqen me interes e sa vepra e kryevepra letrare janë shkruar duke pasur për bazë gjithashtu përrallat!

Vihet re se në të njëzetë përrallat e këtij libri, të gjitha kanë përfundim fatlum, duke triumfuar personazhi kryesor. Kush u ndihmon këtyre njerëzve për të triumfuar? Ja një pyetje që zgjon interesimin dhe kërshërinë tonë për të veneruar se këtyre trimave të përrallave u ndihmojnë, pos qenieve mitologjike, (që nganjëherë edhe i pengojnë), edhe sendet e natyrës së vdekur; sendet e botës bimore dhe shtazore. Këto sende janë herë magjike herë mrekullibërëse, sepse bëjnë aso mrekullish që u vijnë në dihmë njerëzve që synojnë të shpëtojnë, bije fjala, nga kuçedra etj. Le t'i vërejmë konkretisht këto në përrallat e këtij libri.

Në përrallën e parë për Kraveviq Markon ose Kral Markon ose Kraveviq Markon si haset në letërsinë popullore,

re, zana i dhuron trimit *tri bimë*: njëra që i sjell *fëmijë*, e dyta — *të holla*, e treta që *ta ruajë nga çdo e keqe a mynxyrë*. Edhe nëntë burimet e malit që i ka ndryrë zana duhet nënkuptuar si qëllim të forcave të mbrapshta në dëm të njerëzimit, tendencë që personazhi kryesor të i kundërvihet për të rrjedhë të nëntë burimet që mali të ketë blerim, fushat e pemët — begati. Mrekulli të ngjashme hasen, po nga sendet magjike, edhe në përrallën „*Kali i zanës: paktoni i argjendit*” që sjell pasuri, *pendla e patës* — nder, *hurse gërsheta e gjetur* — famë e lavdi. Te përralla „*Klloçka me dymbëdhjetë zogjtë*” — *tre frerët e argjendit* sjellin kuaj me flatra që vijnë nga deti e kthehen e rrijnë në det. Gjithashtu në përrallën „*Mbretëresha memece e detit*” e ëma i jep tri leskra peshku, që këto leskra magjike mrekullibërëse t'i bëhen shërbëtore dhe e nis vajzën për t'u bërë nuse e birit të mbretit. Triumfi i së drejtës del në shesh për bukuri në përrallën „*Trimi i pavdekshëm*” që triumfon edhe pas shumë pengesave e kurthave të kurdisur, për çudi, nga nëna, që në këtë përrallë është fytyrë negative.

Derisa në të gjitha përrallat e tjera zakonisht ambienti i ngjarjes nuk dihet, nuk identifikohet as historikisht as gjeografikisht, në përrallën „*Siljan Lejleku*” kemi një veçori interesante: na jepet emri konkret Siljan, që haset edhe sot ndër maqedonas, e gjithashtu edhe emri i vendit identifikohet — thuhet se ky na qenka nga Prilepi (fshati Konjare) dhe se udhëton për Selanik, dhe pas shkatërrimit të lundrës, gjendet i vetmuar në një ishull ku njerëzit shndërroheshin në lejlekë, pikërisht nëpërmjet sendeve mrekullibërëse — burimeve të malit. Për vlerën estetikë e polivalente shquhet përralla „*Zogu i artë*”. Është një përrallë fort e bukur. Kjo e ka variantin edhe ndër popuj të tjerë. Lexuesve tanë do t'ua kujtojë përrallën shqipe me titull „*Tri motrat*”. (Në përrallën shqipe „*Tri motrat*” më e vogla thotë se do të lindë djalë me yll në ballë për dallim nga kjo e popullit maqedonas ku thuhet se do të lindë me flokë të artë e dhëmbë të argjendit). ... „*Hyn në kopshtin tim — i tha Dielli, këput një mollë të pruar,*

shko në shtëpi, preje, e ka për të dalë një vashë jo e leme prej nëne. Vasha ka për të të kërkuar bukë e kripë dhe pastaj do të jetë nusja jote përjetë" — ja kështu i thotë Dielli trimit që shkon tek ai. Dy herë e në dy përralla (në „Vasha diellore” dhe te „Zogu i artë”) takohemi me mirësitë që bën dielli. Le të vihet re pra: po të kesh tri thërrime buke nga ato që ha dielli, shërohet uloku ose i shituari nga zanat, e tash, po të kesh një mollë nga kopshti i Diellit, të plotësohet edhe një dëshirë e madhe: merr nuse që s’është e leme prej nëne. Sa largpamës është krijuesi i popullit — çdo gjë që vjen nga Dielli është e dobishme, e bukur, e mirë. A nuk thotë populli: Ku hyn dielli nuk hyn mjeku?! Simbolikë të ngjashme gjejmë edhe te përralla „Zogu i artë”, sidomos te fjalët: „...Ka në botë një vend ku jeton zogu i artë, i mbyllur në kafaz të artë dhe flet si njeri, kupton gjithçka që mejton njeriu dhe gjithçka që do t’i ngjajë atij në jetë...” Te „Dynja Gjyzeli” bie në sy veçoria e stilit të dendur e poetik: „...Në mes të detit — një kullë, në kullë — dritare, në dritare — një vashë, vasha që ndrit dynjanë... („Dynja Gjyzeli”). Po të krahasohet me përrallën shqipe, secili mund të vërejë elementin poetik favorizues në dobi të përrallës shqipe për shumë aspekte, por sidomos për aspektin poetik. Pa hyrë shumë në metodën krahasimtare, vetëm mund të përmendet parimi estetik pa përskrime të tipareve, por me fjalën *E bukura e dheut*, që tejkalon të gjitha përskrimet edhe më të hollësishme. Por te përralla maqedone bie në sy një temë shumë e rrallë: babai mbret pi helmin pse s’mund të shihte askend, pra as edhe të birin me të bukurën Dynja Gjyzeli.

„Vasha e fjetur” ka kohën e për caktuar, atë të sundimit turk. Vashës së fjetur i qasen tre barinj, por as njeri nuk pati guxim ta ngasë, kur ajo tha se ka të zgjedhurin ose të dashurin e saj. Por i huaji nuk veproi kështu: turqit e grabisin vashën duke fjetur e ja dërgojnë sulltanit. Ç’ngjan më tutje, marrim vesh, kur i qasemi fundit të këtij tregimi poetik me fjalët: „...nuk e preu mollën e artë Gjergjina e re, po e nguli në ze-

mrën e saj rinore. Ra e shtrirë në divan dhe foli ngadalë — le ta dijë sulltani se nuk rrëmbehen vashat në gjumë”.

Takimi i vashës së fjetur me bari-njtë është një tablo e gjallë poetike që do të kënaqë shijen estetike të secilit:

„...Bariu i parë nxori kavallin që me këngë ta zgjojë e ta dashurojë. Vasha ëndërroi një gjarpër lara-lara që po i fishkëllonte nëpër bar, për ta kafshuar mu në zemër. Bariu i dytë këputi një filizë, e lagu me ujë të burimit, pastaj e stërpiku në fytyrë bukuroshen, për ta zgjuar dhe për ta dashuruar. Vasha ëndërroi një re të nxirë që po derdh pika shiu nëpër ballë dhe fytyrë të saj që po digjej zgjarr. Bariu i tretë u ul pranë saj, ia nxori gërshetën nga dora, që ta zgjojë e ta dashurojë. Vasha ëndërroi një kokërr mollë me një thikë, u trishtua dhe u zgjua. Tundi vetullat, krahë dallëndysheje, i pa tre barinjte”.

Te përralla „Arapin dhe i biri i mbretit” gjithashtu hasim tri sendet që bëjnë mrekulli në dobi të personazhit kryesor: *torba e tagjisë së kalit* shndërrohet në mal e dorëza në *ferra* të çuditshme për ta penguar Arapin që ndiqte djaloshin. Interesin tonë do ta zgjojë edhe çështja që bariu plak i le trashëgim të birit të tij një libër me porosi që ta mbajë me vete gjithmonë e kur të bjerë ngushtë ta nxjerrë e të këndojë („*Tri motrat*”). Në përrallën „*Djali me diell e hënë*”, pos trimit, kemi edhe tre personazhe të çuditshme me emra gjithashtu të çuditshëm: *Tokë-Dëgjuesin*, *Lumë-Gëlltitësin* dhe *Mal-Kaluesin*. I pari dëgjon ç’flitet në gjithë dheun, i dyti gëlltit lumin e detin, i tretë me një hap kalon male e dete. A nuk e pohon kjo në mënyrë simbolike të vërtetën se letërsia i prin një realiteti, se ajo, që dikur ka qenë ëndërr, me kalim të kohës vjen e bëhet realitet. Gjithkush me këta tri personazhe nënkupton shpikjet e reja shkencore.

Libri „*Kali i Zanës*” (Përralla popullore maqedone) nuk është i pajisur me aparaturën e zakonshme shkencore dhe nuk e ka këtë apa-